1. Informacion i përgjithshëm

Strabag AG – Degë e Shoqërisë së Huaj është degë e Strabag AG LLC regjistruar në Shqipëri dhe angazhuar në aktivitetet e ndërtimit.
Adresa e regjistruar e shoqërisë është Rruga "Bardhok Biba", Old Tirana Building, Tiranë, Shqipëri.
Shoqëria është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në korrik 2007 me NIPT K74401601R.

Më 31 dhjetor 2018, shoqëria ka 2 punonjës. (2017: 4).

2. Bazat e përgatitjes

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

2.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

2.3 Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5 Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)

2.5.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Adoptimi i IFRS 9 "Instrumentat Financiare"
Shoqëria ka adoptuar IFRS 9, Instrumentat Financiar, nga 1 janar 2018. Kompania zgjodhi të mos rishikojë shifrat krahasuese dhe ka njohur çdo rregullim të vlerës kontabël të aktiveve dhe pasiveve financiare në fitimet e mbartura të hapura që nga data e zbatimit fillestar të standardeve, më 1 janar 2018. Si rrjedhojë, kërkesat e rishikuara të SNRF 7, Instrumentat Financiarë: Dhënia e informacioneve shpjeguese është zbatuar vetëm për periudhën aktuale. Dhënia e informacioneve shpjeguese për periudhën krahasuese përsërit ato informacione shpjeguese të bëra në vitin paraardhës.

Adoptimi i IFRS 15 "Të ardhura nga kontratat me klientët"
Kompania njef të ardhurat kur përmbush kushtet e performancës gjatë kohës vetëm nëse ajo mat në mënyre të arsyeshme progresin kundrejt përmbushjes së plotë të kushteve të performancës. Kontrata me klientin konsiderohet si një kusht i vetëm performance.

Kompania njeh të ardhurat duke përdorur metodën e kostos plus marzhin kur kostoja është vlersuar duke përdorur metodën input për njohjen e të ardhurave.
Kompania përjashton nga metoda input efektin e çdo malli apo shërbimi për të cilin ajo nuk transferon kontroll tek klienti.

Kompania konsideron kushtet e kontratës dhe ka përcaktuar çmimin e transaksionit bazuar në vlerën e kontratës. Çmimi i transaksionit është shuma korresponduese për të cilën pret të ketë të drejtë një njësi ekonomike në këmbim të transferimit tek klienti të mallrave apo shërbimeve të premtuara, duke përjashtuar shumat e mbledhura për llogari të palëve të treta (për shembull, taksat mbi shitjen).

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

2.5.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale (vazhdim)

Adoptimi i IFRS 15 "Të ardhura nga kontratat me klientët" (vazhdim)
Deri më 31 dhjetor 2018 kompania ka njohur të ardhurat duke përdorur metodën e kostos plus marzhin. Si rezultat i këtij adoptimi të SNRF 15 nuk ka rezultuar me rregullime në pasqyrat financiare.

Supozimet e rëndësishme dhe gjykimet lidhur me SNRF 15 janë paraqitur në shënimin 4.

Standardet e ndryshuara në vijim bëhen efektive për Shoqërinë më 1 janar 2018, por nuk kanë pasur ndonjë ndikim material në Kompani:

- Ndryshimet në SNRF 2 "Pagesa me aksione" (lëshuar më 20 qershor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- Ndryshimet në SNRF 4 - "Zbatimi i SNRF 9 Instrumentet Financiare me SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve" (lëshuar më 12 shtator 2016 dhe efektive, varësisht nga qasja, për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018 për subjektet që zgjedhin të aplikojnë opsionin e përjashtimit të përkohshëm ose kur njësia ekonomike së pari aplikon SNRF 9 për njësitë ekonomike që zgjedhin të zbatojnë metodën e mbivendosjes).
- Përmirësimet vjetore të ciklit të SNRF 2014-2016 - Ndryshimet në SNRF 1 të SNK 28 (i publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- KIRFN 22 "Transaksionet në monedhë të huaj dhe Konsiderata paraprake' (lëshuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- Ndryshimet në SNK 40 - "Transferet e Pronës së Investimit" (lëshuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).

2.5.2 Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të pa pervetesuara

Ka një numër standardesh dhe interpretimesh të cilat janë nxjerrë nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit që janë efektive në periudhat e ardhshme të kontabilitetit që Kompania ka vendosur të mos i aplikojë më herët. Kompania planifikon ti aplikojë këto ndryshime kur të hyjnë në fuqi.

SNRF 16, Qiratë (publikuar më 13 janar 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019). Standardi i ri përcakton parimet për njohjen, matjen, prezantimin dhe paraqitjen e qirasë. Të gjitha qiratë pothuajse rezultojnë që qiramarrësi të ketë të drejtën e përdorimit të një aktivi në fillim të qirasë dhe, nëse pagesat e qirasë bëhen përgjatë kohës të marrë edhe financim. Rrjedhimisht, SNRF 16 eliminon klasifikimin e qerave si qera operacionale ose qira financiare siç kërkohet nga SNK 17 dhe, në vend të kësaj, prezanton një model të vetëm të kontabilitetit të qiramarrësit. Qiramarrësi do të kërkohet që të njohë: (a) aktivet dhe detyrimet për të gjitha qiratë me një afat më të gjatë se 12 muaj, përveç nëse aktivi nëfjalë është me vlerë të vogël; dhe (b) zhvlerësimin e aktiveve të marra me qira veç nga interesi për detyrimet e qirasë finaciare në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. SNRF 16 në thelb ka të njëjtat kërkesa me SNK 17 për trajtimin kontabël të qirave në këndvështrimin e qiradhënësit. Ndaj, një qiradhënës vazhdon të klasifikojë qiratë e tij si qera të zakonshme ose qera financiare dhe të bëjë llogaritjet bazuar në llojin e qerasë.

Shoqëria ka vendosur zbatimin e standardit nga data e saj e adoptimit të detyrueshëm, data 1 janar 2019 duke përdorur metodën retrospektive të modifikuar, pa riparaqitje të shifrave krahasuese.

Ndryshimet që mund të jenë relevante për Shoqërinë, por nuk pritet të kenë ndonjë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të saj, janë paraqitur më poshtë:

- KIFRN 23 "Paqartësi mbi Trajtimet e Tatimit mbi të Ardhurat" (në fuqi më 1 janar 2019).
- Përmirësimet vjetore (cikli 2015-2017) (i detyrueshëm për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

2.5.2 Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të pa pervetesuara (vazhdim)

- Ndryshimet në SNRF 9 "Tiparet e Parapagimit me Kompensim Negativ" (në fuqi më 1 Janar 2019).
- Ndryshimet në SNK 19 "Ndryshimet e planit, kufizimet dhe vendbanimet" (të detyrueshme për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- Ndryshimet në SNK 28 "Interesat Afatgjatë në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta" (e detyrueshme për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve" (që zbatohen në mënyrë të detyrueshme për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021).

2.6 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar kërkon që Drejtimi të bëjë gjykimet, vlerësimet dhe supozimet të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre vlerësimeve.
Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.
Informacionet në lidhje me zonat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë dhe gjykimit kritik në aplikimin e politikave kontabël të cilat më së shumti ndikojnë në paraqitjen e shumave në pasqyrat financiare, janë paraqitur në shënimin nr. 5.

3. Politika të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë aplikuar në të gjitha periudhat e pasqyruara në këto pasqyra financiare dhe në mënyrë të vazhdueshme nga Shoqëria.

3.1 Të ardhurat nga kontratat dhe fitimi

Të ardhurat nga kontratat përfshijnë vlerën totale të punës ndërtimore të kryer gjatë vitit. Fitimi nga kontratat afatgjata njihet me përqindjen e rregulluar mbi bazë të përfundimit. Asnjë fitim nuk merret deri kur një kontratë nuk ka avancuar deri në pikën ku fitimi përfundimtar i realizueshëm mund të përcaktohet në mënyrë të arsyeshme. Provizionet janë krijuar për të gjitha humbjet e shkaktuara në datën e raportimit plus për cdo humbje të mëtejshme të parashikuar për sjelljen e kontratave drejt përfundimtit.

3.2 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.2 Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
EUR/ Lek	123.42	132.95

3.3 Instrumenta financiarë

Politika të aplikueshme nga 1 janar 2018

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

Instrumentat financiare – njohja fillestare. Instrumentet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare përcaktohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Pas njohjes fillestare, një humbje e pritshme e kredisë (HPK) njihet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – kategoritë e matjes. Kompania klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: VDNFH, VDATGJ dhe KA. Klasifikimi dhe matja pasuese e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) modeli i biznesit i kompanisë për menaxhimin e portofolit të aktiveve të lidhura dhe (ii) karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare të aktivit.

Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – modeli i biznesit. Modeli i biznesit pasqyron mënyrën se si Kompania menaxhon pasuritë në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare - nëse objektivi i Kompanisë është: (i) vetëm për të mbledhur flukse monetare kontraktuale nga aktivet ("mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale") ose (ii) për të mbledhur të dyja flukset e mjeteve monetare kontraktuale dhe flukset e mjeteve monetare që rrjedhin nga shitja e aktiveve ("duke arkëtuar flukse mjetesh monetare kontraktuale ashtu dhe duke shitur aktive financiare") ose, nëse asnjë nga (i) dhe (ii) nuk aplikohet, si pjesë e modelit të biznesit "të tjerë" dhe të matur në VDNFH.
Modeli i biznesit përcaktohet për aktivet individuale financiare (në nivel individual) bazuar në të gjitha dëshmitë përkatëse për aktivitetet që Kompania ndërmerr për të arritur objektivin e caktuar për aktivin në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktorët që konsiderohen nga kompania në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë: qëllimin e aktivit, përvojën e kaluar në mënyrën se si janë arkëtuar flukset e mjeteve monetare për aktivet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si menaxherët kompensohen.

Aktivet financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – karakteristikat e fluskeve monetare. Kur modeli i biznesit është mbajtja e aktiveve për të mbledhur flukse monetare kontraktuale ose për të mbajtur flukse monetare kontraktuale dhe për ti shitur, kompania vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit ("VPPI"). Gjatë marrjes së këtij vlerësimi, kompania konsideron nëse flukset monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, pra interesi përfshin vetëm konsideratën për rrezikun e kredisë, vlerën në kohë të parasë, rreziqet e tjera të huadhënies dhe marzhin e fitimit. Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj rrezikut ose paqëndrueshmërisë që nuk është në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, aktivi financiar klasifikohet dhe matet në VDNFH. Vlerësimi i VPPI kryhet në njohjen fillestare të një aktivi dhe nuk rivlerësohet më pas. Referojuni Shënimit 4 për gjykimet kritike të aplikuara nga Kompania në kryerjen e provës VPPI për asetet e saj financiare.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.3 Instrumenta financiarë (vazhdim)

Aktivet financiare – pakësimi i vlerës. Shoqëria do të pakësojë vlerën bruto të mbartur të një aktivi financiar kur njësia ekonomike në mënyrë të arsyeshme nuk pret të rikuperojë vlerën e plotë apo një pjesë të këtij aktivi financiar. Pakësimi i vlerës përfaqëson një ngjarje çregjistrimi. Treguesit që nuk ka parashikime të arsyeshme të rimëkëmbjes përfshijnë shkelje të kushteve të kontratës si vonesa në pagesa ose ngjarje të mos pagesës në kohë, paaftësi paguese dhe falimentim. Kompania mund të çvlerësojë aktivet financiare që ende i nënshtrohen veprimtarisë së zbatimit kur Kompania kërkon të rimarrë shumat që janë për pjesë e kontratës, megjithatë, nuk ka shpresa të arsyeshme për rimarrje.

Aktivet financiare - çregjistrimi. Shoqëria çregjistron aktivet financiare kur (a) përfundojnë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar ose (b) kompania ka transferuar të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivet financiare ose kanë hyrë në një marrëveshje ku ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar ("aktivi fillestar"), por merr përsipër një detyrim kontraktual për t'ua paguar këto flukse të mjeteve monetare një ose më shumë njësive ekonomike pra kur (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të aktivit financiar, ose (ii) nuk ka ruajtur kontrollin dhe as nuk transferon, as nuk man thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar. Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur asetin në tërësi tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

Detyrimet financiare – kategorite e matjes. Detyrimet financiare klasifikohen si të matura më pas me Koston e Amortizuar (KA), përveç (i) detyrimeve financiare të matur me VDNFH. Ky klasifikim zbatohet për derivativët, detyrimet financiare të mbajtura për tregtim (p.sh. pozicionet e shkurtra në letra me vlerë), shumës së kushtëzuar të njohur nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë.

Detyrimet financiare – çregjistrimi. Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato shuhen (dmth. Kur detyrimi i specifikuar në kontratë shkarkohet, anulohet ose skadon).

Kompensimi i instrumenteve financiare. Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe raportohet shuma neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për kompensimin e shumave të njohura dhe ka një qëllim që të shlyhet në baza neto ose të realizojë aktivin dhe zgjidhë detyrimin në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë e kompensimit (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërisht e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast vonese të pagesave dhe (iii) në rast të paaftësisë së pagesës ose falimentimit.

Kompania zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative, të përbërë nga llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe llogari të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, llogaritë e pagueshme tregtare dhe llogari të tjera, kreditë e tjera. Të gjitha instrumentet financiare fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare të Kompanisë maten me koston e amortizuar.

Vlera e drejtë është shuma në të cilën një instrument financiar mund të këmbehet në një transaksion të tanishëm midis palëve të gatshme, përveçse në një shitje të detyruar ose likuidim, dhe dëshmohet më së miri nga një çmim aktiv i kuotuar i tregut. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv (asnjë nga aktivet financiare të Kompanisë nuk tregtohet në një treg aktiv) përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit. Në njohjen fillestare, vlera e drejtë e të gjitha aktiveve financiare vlerësohet të përafrohet me koston e tyre të transaksionit.
Kostoja e amortizuar është shuma në të cilën instrumenti financiar është njohur në momentin fillestar minus çdo ripagim të principalit, plus interesin e përllogaritur, dhe minus çdo kompensim për humbjet e pritura të kredisë për aktivet financiare.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.3 Instrumenta financiarë (vazhdim)

Politika të aplikueshme para 1 janar 2018

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.
Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.
Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.
Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërise skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre
Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme
Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogaritë e pagueshme
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera janë deklaruar me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Huatë
Huate janë njohur fillimisht me vlerën e drejtë, neto nga kostot e transaksioneve dhe më pas njihen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, me shpenzime interesi të njohura bazuar në normën efektive.
Metoda e interesit efektiv është metoda e llogaritjes të kostos së amortizuar të detyrimit financiar dhe e alokimit të shpenzimit të interesit pergjatë periudhës përkatëse. Norma efektive e interesit është norma që skonton saktësisht vlerat e ardhshme të parave pergjatë jetëgjatësisë së planifikuar të detyrimit financiar, ose, kur është e pershtatshme, për një periudhë më të shkurtër vlerën e mbetur neto nga njohja fillestare.

Vlera e drejtë
Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera
Të tjera instrumenta financiare jo derivative janë matur me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.3 Instrumenta financiarë (vazhdim)

Zhvlerësimi i aktiveve financiare
Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.4 Inventari

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.
Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

3.5 Prodhimi në proçes

Prodhimi në proçes në kontratat afatgjata llogaritet me kosto plus fitimin që i atribuohet, në masën që është e arsyeshme me pas krijimi provizioneve për kontigjencat, minus ndonjë humbje të ndodhur ose të parashikuar për të sjellë kontratat drejt perfundimit dhe minus shumat e arkëtuara ose për tu arkëtuar si pagesa në progres. Për këtë arsye, kostot përfshijnë të gjitha kostot direkte të kontratave. për cdo kontratë kur arktëtimet plus të arkëtueshmet tejkalojnë vlerën kontabël të punës së kryer diferenca e shtuar përfshihet në llogaritë e pagueshme dhe të shtyrat.

3.6 Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë matur me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi i akumuluar.

Kostot përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivit. Kosto e aktivit të ndërtuar vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër direkte të lidhur me vënien e aktivit në kushtet e punës për përdorimin e parashikuar, kostot e çmontimit dhe heqjen e pjesëve dhe restaurimin e zonës në të cilat ato janë vendosur dhe kostot e huamarrjes së kapitalizuara. Programi i blerë që është pjesë përbërëse në funksionimin e një pajisjeje është kapitalizuar si pjesë e pajisjes.
Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato llogariten si zëra të ndara (pjesë të rëndësishme) të akteveve afatgjata materiale.
Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e ndonjë zëri të akteveve afatgjata materiale janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat e marra nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën kontabël (neto) të akteveve afatgjata materiale dhe janë pasqyruar neto në të ardhura të tjera në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.6 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të pronave, makinerive dhe pajisjeve është njohur në vlerën kontabël (neto) të pjesës në qoftë se është e mundur që në të ardhmen të mirat ekonomike të përfshira në atë pjesë do t'i vijnë Shoqërisë dhe kostoja mund të matet me besueshmëri. Vlera kontabël (neto) e pjesës që zëvendësohet hiqet nga regjistrimet. Kostot e shërbimeve të përditshme të pronave, makinerive dhe pajisjeve janë të njohura në të ardhurat ose shpenzimet kur ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi është llogaritur mbi vlerën e amortizueshme, e cila është kostoja e aktivit duke zbritur vlerën e mbetur. Amortizimi njihet me normat si më poshtë në bazë të vlerës së mbetur:

Ndërtesa	5%
Mobilje dhe orendi	20%
Mjetet e transportit	20%
Pajisje kompjuterike	25%
Makineri dhe pajisje	20%

Këto norma reflektojnë më së shumti vlerën e pritshme të konsumit të përfitimeve të ardhshme ekonomike që burojnë nga aktivet afatgjata materiale. Prodhimi në proces nuk amortizohet.
Normat e amortizimit dhe vlera e mbetur e aktiveve afatgjata materiale rivlerësohen në çdo datë raportimi.

(iv) Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.
Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

(i) Aktivet financiare

Një aktiv financiar jo i mbartur me vlerë të drejtë nëpermjet fitimit dhe humbjes është vlerësuar në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë evidencë objektive për ta zhvlerësuar. Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive që tregon se një ngjarje zhvlerësimi ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit dhe ka patur një ndikim negativ në rrjedhjen e ardhshme monetare të vlerësuara të aktivit financiar dhe këto efekte janë të matshme në mënyrë të besueshme.

Një humbje nga zhvlerësimi në lidhje me një aktiv financiar të matur me kosto të amortizuar është llogaritur si diferencë mes vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parasë të vlerësuara duke i skontuar me normën origjinale efektive të interesit të aktivit. Humbjet janë njohur në të ardhura dhe shpenzime dhe janë reflektuar në një llogari zbritje nga llogaritë e arkëtueshme. Interesi mbi një aktiv të zhvlerësuar vazhdon të njihet nëpërmjet skontimit te qendrueshem. Kur një ngjarje e ardhshme (p.sh. shlyerja e një debitori) shkakton një rënie në shumën e humbjes nga zhvlerësimi, rënia në humbjen nga zhvlerësimi rimerret nëpërmjet fitimit ose humbjes.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.6 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

(ii) Aktive jo financiare

Vlerat kontabël të aktiveve jofinanciare të Shoqërisë janë rishikuar në datën e raportimit për të përcaktuar në qoftë se ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Në qoftë se ndonjë tregues i tillë ekziston, atëherë llogaritet vlera e rikuperueshme e aktivit. Shuma e rikuperueshme është vlera më e lartë midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e vlerësuara monetare të ardhshme janë zbritur për vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike për aktivin për të cilat vlerësimet e flukseve monetare të ardhshme nuk janë rregulluar.
Humbjet nga zhvlerësimi njihen në qoftë se vlera e mbartur e aktivit apo pjesa e burimit të parave e kalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në të ardhura ose shpenzime.

3.7 Provizione

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.8 Pagesat e qirasë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Shoqëria ka vetem qira operative.

3.9 Përfitimet e punëmarrësve

Kontributet e detyrueshme shoqërore

Një plan i kontributit të përcaktuar është një plan përfitimi pas periudhës së punësimit sipas të cilit një njësi ekonomike paguan kontribute në shuma fikse në një entitet të veçantë dhe nuk ka asnjë detyrim ligjor apo konstruktiv për të paguar shuma të mëtejshme. Qeveria e Shqipërisë është përgjegjëse për sigurimin e pensioneve në Shqipëri, sipas një plani të përcaktuar të kontributeve të pensionit. Kontributet e Shoqërisë në planin e përcaktuar të kontributeve të pensionit njihen si një shpenzimi përfitimit të punonjësve në të ardhura dhe shpenzime në periudhat gjatë të cilave kryhen shërbimet nga të punësuarit.

3.10 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat për fondet e depozituara në bankë dhe fitimet nga kurset e këmbimit. Të ardhurat nga interesat njihen kur realizohen duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit, humbjet nga kurset e këmbimit dhe humbjet nga zhvlerësimi të njohura në aktivet financiare.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.11 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përbëhet nga tatimi i periudhës dhe tatimi i shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në të ardhura ose shpenzime përveç rasteve kur lidhen me zëra të njohur direkt në kapital apo në të tjera të ardhura gjithëpërfshirëse.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar apo arkëtuar mbi fitimin e tatueshëm apo humbjen për vitin, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme. Normat e tatimimit për vitin 2018 është 15% (2017: 15%).

Tatimi i shtyrë njihet duke paraqitur diferencat e përkohshme midis vlerave kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato të kthehen, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit.

Një aktiv për tatimin e shtyrë njihet nëse është e mundshme që të ardhura të tatueshme të ardhshme do të realizohen kundrejt të cilave mund të përdoren diferencat e përkohshme. Aktivet e tatimit të shtyrë rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri sa nuk janë më të mundshme të realizohen përfitime tatimore të lidhura me të.

Në përcaktimin e vlerës së tatimit të periudhës dhe tatimit të shtyrë Shoqëria merr në konsideratë ndikimin e pasigurtë të pozicionit të taksave dhe nësemund të ngarkohen taksa shtesë ose interesa. Shoqëria beson se shpenzimet e përllogaritura të saja për detyrimet tatimore janë të përshtatshme për të gjitha vitet tatimore të hapura bazuar në vlerësimin e saj për shumë faktorë, duke përfshirë interpretime të ligjit të taksave dhe përvojave të mëparshme. Ky vlerësim mbështetet nëparashikime dhe supozime dhe mund të përfshijë një seri gjykimesh për ngjarjet e ardhshme. Informacione të reja mund të bëhen të disponueshme duke ndikuar në ndryshimin e vendimit të Shoqërisë në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; ndryshime të tilla në detyrimet tatimore do të ndikojë në shpenzimet tatimore në periudhën që është bërë një përcaktim i tillë.

3.12 Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme jane ne vleren origjinale te fatures minus nje provizion per vlerat e pa arketueshme. Nje perllogaritje e te arketueshmeve te dyshimta behet kur arketimi i vleres se plote nuk eshte me i mundur. Borxhi i keq cregjistrohet ne rast se nuk ka mundesi marrje.

3.13 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.14 Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit

Vlerësimet dhe gjykimet janë vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme dhe janë bazuar në eksperiencat historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë edhe pritshmërinë për ngjarjet e ardhshme për të cilat besohet të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave.
Shoqëria bën vlerësime dhe supozime lidhur me të ardhmen. Rezultati i vlerësimeve kontabël, sipas përcaktimit, rrallë do të jetë i barabartë me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet të cilat kanë një risk të konsiderueshëm për shkaktimin e një sistemimi material në shumat e mbartura të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë trajtuar si më poshtë.

Njohja e të ardhurave

Më poshtë listohet gjykimet e bëra në aplikimin e SNRF 15 që kanë ndikim të rëndësishem në përcaktimin e shumës dhe kohës se njohjes së të ardhurave nga kontratat me klientet.

Shoqëria plotëson kriteret e SNRF 15 paragrafi 35 për njohjen e të ardhurave përgjate kohës së kontratës. Këto kritere përfshijne:

- Aktiviteti i Shoqërise krijon ose përmirëson në aktiv (për shëmbull, punim në proçes) i cili kontrollohet nga klienti gjatë kohës që ai krijohet apo përmiresohet.
- Aktiviteti i Shoqerise nuk krijon ndonjë aktiv që mund të përdoret ndryshe dhe shoqeria ka një të drejtë të ekzekutueshme me forcë për t'u paguar lidhur me performancën e realizuar deri në atë datë.

Shoqëria njeh të ardhurat që lidhen me kushtet e performancës të përmbushura në kohë vetëm nëse ajo mund të masë në mënyrë të arsyeshme progresin ndaj realizimit të plotë të kushteve të performancës. Kontrata me klientin trajtohet si një kusht i vëtëm performance.

Shoqëria njeh të ardhurat duke përdorur metodën kosto plus marzh ku kosto përcaktohet sipas metodës input të njohjes së të ardhurave. Shoqëria përjashton nga metoda input efektet e çdo inputi që nuk paraqet performancën e njësisë ekonomike në transferimin e kontrollit të mallrave apo shërbimeve tek klienti.

Kompania konsideron kushtet e kontratës dhe ka përcaktuar çmimin e transaksionit bazuar në vlerën e kontratës. Çmimi i transaksionit është shuma korresponduese për të cilën pret të ketë të drejtë një njësi ekonomike në këmbim të transferimit tek klienti të mallrave apo shërbimeve të premtuara, duke përjashtuar shumat e mbledhura për llogari të palëve të treta (për shembull, taksat mbi shitjen). Në percaktimin e cmimit të transaksinit merren në konsiderate:

- shumën korresponduese të ndryshueshme
- kufizimin në vlerësimet e shumës së ndryshueshme
- ekzistencën e një përbërësi financues të rëndësishëm në kontratë
- shumën korresponduese jo monetare
- shumën korresponduese të pagueshme ndaj klientit

Deri në 31 dhjetor 2017 shoqëria ka njohur të ardhurat duke përdorur metodën kosto plus marzh. Si rezultat, aplikimi i SNRF 15 nuk ka rezultuar në ndonje korrigjim të pasqyrave financiare.

Tatimi mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Një gjykim i rëndësishëm është kërkuar për të përcaktuar vlerat e tatim fitimit të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar fiskal është i pasigurt. Kur rezultati përfundimtar tatimor ndryshon në mënyrë të rëndësishme me shumat të cilat janë regjistruar fillimisht, diferenca të tilla do të ndikojnë në aktivet dhe detyrimet aktuale ose të shtyra të tatim fitimit në periudhën në të cilën është bërë një vlerësim i tillë.

4. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit (vazhdim)

Vlerësimi i modelit të biznesit

Modeli i biznesit orienton klasifikimin e aktiveve financiare. Gjatë vlerësimit të transaksioneve të shitjes, Kompania konsideron frekuencën, kohën dhe vlerën e tyre historike, arsyet për shitjet dhe pritjet për aktivitetin e shitjeve të ardhshme. Transaksionet e shitjeve që kanë për qëllim minimizimin e humbjeve të mundshme për shkak të rrezikut të kredisë mund të jetë në përputhje me modelin e biznesit objektivi i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale. Shitjet e tjera para maturimit, jo të lidhura me aktivitetet e administrimit të rrezikut të kredisë, janë gjithashtu në përputhje me modelin e biznesit objektivi i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale, me kusht që ato të jenë të rralla ose të parëndësishme në vlerë, si individualisht dhe në tërësi.

Kompania vlerëson rëndësinë e transaksioneve të shitjes që nga fillimi i aktivitetit të saj të shitjes. Modeli i biznesit "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe për të shitur" nënkupton që mjetet janë mbajtur për të mbledhur flukset e mjeteve monetare, por shitja është gjithashtu pjesë integrale për arritjen e objektivit të modelit të biznesit, siç janë menaxhimi i nevojave të likuiditetit, arritja e një kthimi të caktuar ose përputhja e kohëzgjatjes së aseteve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë këto asete.

Gjatë kalimit në SNRF 9, kompania identifikoi se:

- Rreziqet kryesore të modelit të biznesit janë në përputhje me modelin "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale" me fokus në rrezikun e kredisë. Asnjë peshë nuk jepet për çmimin ose rrezikun e vlerës së drejtë;
- Deri më tani nuk ka pasur asnjë shitje aktivit financiar. Shitjet do të ndodhin vetëm në përgjigje të përkeqësimit të rrezikut të kredisë nga pala tjetër, që rezulton nga shkeljet e kritereve të brendshme të rrezikut të kredisë. Këto shitje do të ishin në përputhje me modelin "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale". Një shitje për shkak të plotësimit të nevojave të likuiditetit do të ishte rastësore. Prandaj, modeli i biznesit që lidhet me Llogaritë e Arkëtueshme konsiderohet të jetë "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale".

Vlerësimi nëse flukset e mjeteve monetare janë vetëm pagesa principali dhe interesit ("VPPI")

Përcaktimi nëse flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar janë vetëm pagesa principali dhe interesi kërkon gjykim.
Të arkëtueshmet tregtare të Kompanisë përfshijnë një fluks të vetëm të parasë, pagesën e shumës që rezulton nga një transaksion në fushën e zbatimit të SNRF 15, që konsiderohet të jetë principali. Rrjedhimisht, flukset monetare që rrjedhin nga të arkëtueshmet plotësojnë testin VPPI të pagesave të principalit dhe interesit pavarësisht se përbërësi i interesit është zero.

Matjet humbjeve te parashikuara te kredise

Niveli i humbjeve nga zhvlerësimi llogaritet për llogaritë e arkëtueshme të matura me koston e amortizuar. Meqenëse të arkëtueshmet tregtare nuk përmbajnë një komponent të rëndësishëm financimi, niveli i humbjeve do të llogaritet bazuar në humbjet e pritshme të kreditit. SNRF 9 lejon përdorimin e një matricë provizionesh në të cilën llogariten kostot e zhvlerësimit për llogaritë e arkëtueshme të vjetra ose të vonuara.

24. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Politikat e manaxhimit të riskut të Shoqërisë janë hartuar për të identifikuar dhe analizuar risqet e hasura nga Shoqëria, për të vendosur kontrollet dhe limitet e duhura të riskut dhe për të monituar riskun dhe respektimin e limiteve.
Politikat dhe sistemet e manaxhimit të riskut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe aktivitetet e Shoqërisë. Shoqëria, nëpërmjet trajnimeve dhe standardeve e procedurave të manaxhimit të saj, ka si qëllim të zhvillojë një mjedis të disiplinuar dhe konstruktiv të kontrollit në të cilin të gjithë punonjësit janë në dijeni me rolet dhe detyrimet e tyre.
Instrumentat kryesorë financiarë të shoqërisë përbëhen nga mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre, të arkëtueshme dhe të pagueshme dhe të tjera të pagueshme.

(a) Risku i kreditit

Vlera kontabël e aktiveve financiare përfaqëson shumën maksimale të ekspozimit të rrezikut. Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit. Shoqëria monitoron në mënyrë të vazhdueshme arkëtimet nga klientët.

(b) Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që kompania të hasë ndonjë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve të lidhura me detyrimet financiare që likuidohen nëpërmjet parave apo aktiveve të tjera financiare.
Më poshtë paraqiten aktivet dhe pasivet financiare sipas maturitetit kontraktual të tyre më 31 dhjetor 2018 dhe më 31 dhjetor 2017.

	31 dhjetor 2018		
Përshkrimi	**deri në një vit**	**mbi një vit**	**Total**
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	468,912,740	-	468,912,740
Mjete monetare në arkë dhe bankë	86,331,003	-	86,331,003
Totali	**555,243,743**	**-**	**555,243,743**
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(356,198,897)	-	(356,198,897)
Hua	-	-	-
Totali	**(356,198,897)**	**-**	**(356,198,897)**
Rreziku i likuiditetit më 31 Dhjetor 2018	**199,044,846**	**-**	**199,044,846**

	31 dhjetor 2017		
Përshkrimi	**deri në një vit**	**mbi një vit**	**Total**
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	899,243,249	-	899,243,249
Mjete monetare në arkë dhe bankë	84,258,820	-	84,258,820
Totali	**983,502,069**	**-**	**983,502,069**
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(865,687,071)	-	(865,687,071)
Hua	-	-	-
Totali	**(865,687,071)**	**-**	**(865,687,071)**
Rreziku i likuiditetit më 31 Dhjetor 2017	**117,814,998**	**-**	**117,814,998**

24. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(c) Risku i valutës

Ekspozimi ndaj riskut të valutës

Ekspozimi i shoqërise ndaj riskut të monedhës së huaj më 31 dhjetor 2018 dhe më 31 dhjetor 2017 është si më poshtë:

	31 dhjetor 2018		
Përshkrimi	**EUR**	**ALL**	**Total**
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	-	468,912,740	468,912,740
Mjete monetare në arkë dhe bankë	2,307,271	84,023,732	86,331,003
Totali	**2,307,271**	**552,936,472**	**555,243,743**
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(36,704,990)	(319,493,907)	(356,198,897)
Hua	-	-	-
Totali	**(36,704,990)**	**(319,493,907)**	**(356,198,897)**
Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2018	**(34,397,719)**	**233,442,565**	**199,044,846**

	31 dhjetor 2017		
Përshkrimi	**EUR**	**LEK**	**Total**
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	1,319,490	897,923,759	899,243,249
Mjete monetare në arkë dhe bankë	4,012,041	80,246,779	84,258,820
Totali	**5,331,531**	**978,170,538**	**983,502,069**
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(243,919)	(865,443,152)	(865,687,071)
Hua	-	-	-
Totali	**(243,919)**	**(865,443,152)**	**(865,687,071)**
Rreziku i monedhës më 31 Dhjetor 2017	**5,087,612**	**112,727,386**	**117,814,998**

(d) Risku i normës së interesit

Risku i normës së interesit përfaqëson riskun që vlera e instrumentave financiare do të luhatet nga ndryshimet në treg të normës së interesit dhe riskun që maturiteti i aktiveve financiare që mbartin interes të jetë i ndryshëm nga maturiteti i pasiveve financiare që mbartin interes. Gjatësia e kohës në të cilën norma e interesit është fikse për një instrument financiar përcaktohn se në ç'masë është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit. Aktivet dhe detyrimet e shoqërisë mbajnë normat e interesit të tregut. Shoqëria nuk ka hua që mbartin interes.

25. Ngjarje pas datës së raportimit finaciar

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pasdatës së raportimit të cilat do të kërkonin korrigjim ose shënime në pasqyrat financiare.

Mazars

Address
Rruga Emin Duraku, Pall. "Binjaket", Nr.5
Tirane, Shqiperi
Tel. +355 (0) 42 278 015
audit@mazars.al